Si të përktheni informacionin në faqen e internetit të Agjencisë së Shëndetit Publik (PHA) në gjuhë të tjera

Faqja e internetit e PHA-së përdor një shirit veglash të quajtur **Browsealoud** për të lexuar me zë të lartë dhe për të përkthyer faqet e internetit dhe PDF (format dokumenti portativ), por jo imazhe me tekst. Ky shirit ndihmon njerëzit me disleksi, dëmtime të lehta të shikimit ose ata që nuk e kanë anglishten gjuhë të parë, për të aksesuar informacionin në sajt.

Public Health

Ai shërben kryesisht për të lexuar informacion me zë të lartë ose për ta shfaqur atë në një mënyrë tjetër, por mund të përdoret gjithashtu edhe për të përkthyer faqet e internetit në disa gjuhë, duke përdorur Google Translate. Ai e lexon me zë tekstin e përkthyer aty ku ka një zë që përputhet (gjuhët e folura renditen së pari në menunë me lëshim poshtë). Gjuhët renditen alfabetikisht sipas gjuhës së përkthyer (e ndjekur nga anglishtja, nëse përdorni një shfletues të përditësuar).

Shiriti i veglave browsealoud (shfaqet ndryshe në telefonin celular)



Si të përdorni browsealoud në faqen e internetit të PHA-së

Shiriti i veglave të browsealoud	
4	🕞 🚱 🔤 🙆 🛒 ? 🔅 👘 🌚 🔂 🌚 🖓 browsealoud"
Kjo ikonë ndihmëse shpjegon cilësimet e shiritit të veglave ? Për të përkthyer një tekst në PDF	
1	Përzgjidhni ikonën browsealoud (zakonisht në krye djathtas të ekranit).
2	Shiriti i veglave browsealoud do të shfaqet (mund ta ripoziciononi atë).
3	Përzgjidhni gjuhën tuaj nën ikonën e globit.
4	Hapni PDF-në që doni të përktheni.
5	Teksti i përkthyer do të shfaqet në krye të tekstit në anglisht. Pomóż nam śledzić Twoje kontakty Użyj usługi cyfrowego śledzenia kontaktów do pomóc powstrzymać rozprzestrzenianie się COVID-19.
6	Për të printuar tekstin e përkthyer, theksoni tekstin, kopjojeni (ctrl+C) dhe ngjiteni (ctrl+V) në një dokument Word. Mund t'ju duhet ta kopjoni përkthimin seksion pas seksioni për ta ruajtur tekstin në radhitjen e duhur.
7	Për ta ndaluar përkthimin përzgjidhni ikonën e ndalimit dhe përzgjidhni sërish gjuhën angleze në menunë me lëshim poshtë të gjuhës (ikona e globit, shih pikën 3), para së të mbyllni shiritin e veglave.